

Statuti i Shoqerisë me Përgjegjësi të Kufizuar " DHIAMANDI STUDIO" shpk

Neni 1

Sipas ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregetaret dhe ndermarrjet tregtare" dhe ligjet ne fuqi në Republikën e Shqipërisë, anëtarë themelues:

Joana Dhiamandi, e bija e Vasilit, lindur më datë 07/03/1989, në Permet, banuese në Tirane, në rr. Emin Duraku nr.8, H.3, Ap. 3, 1019 identifikuar me ID I95307053P, me kapacitet të plotë juridik për të vepruar.

Vendosi sot me 17 Mars 2021, të themelojë kompaninë "**DHIAMANDI STUDIO**" shpk.

Neni 2

Shoqëria do të mbajë emrin "**DHIAMANDI STUDIO**" këtu dhe siç raportohet më poshtë.

Neni 3

Forma ligjore

Shoqëria do të ketë formën e vet ligjore, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar në pajtim me ligjin nr.9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 4

Baza Ligjore

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në perputhje me aktin e themelimit, nga statuti aktual, nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 5

Kohëzgjatja

Aktiviteti i shoqërisë do të fillojë në datën e regjistrimit në QKB. Veprimtaria e shoqërisë do të zgjasë pa limit.

Neni 6

Selia

Shoqëria do të ketë seline e saj në Tirane, Rr. Irfan Tomini, nr 118/8, 1019, Tirane.

Shoqëria ka të drejtën të themelojë degë dhe përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë vendit, me vendim të ortakëve themelues.


Shoqëria ofron mundësinë për të marrë pjesë në kompani të tjera ekzistuese ose të ardhshme që do të zhvillojnë aktivitetenë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë vendit me vendimin e ortakut themelues.

Neni 7

Objekti

Objekti i shoqërisë do të jetë:

- Projekte arkitektonike,
- Projekte inxhinierike
- Auditime dhe zbatime te projekteve
- Eficiencë energjie



- Sherbime te natyres se projektimeve, drejtimit dhe ndihmes teknike te punimeve me personel te kualifikuar, rilevime topografike, punime topogjodezike, qendrueshmeri dhe perforcim themelesh, ndertim dige te larte.
- Asistence teknike, juridike etj.
- Sherbime te natyrave te ngjashme per te cilat shoqeria do te pajiset me licencat perkatese.
- Sherbime ne planifikim urban.
- Projektime interiere dhe pejsazhi, sistemim siperfaqe te gjelbra lulishte dhe parqe,
- Projektim dhe mbikqyrje aeroporte, helioporte, hekurudha,tunele rrugore-hekurudhore.
- Projektim e mbikqyrje vepra hidraulike.
- Studime dhe vleresime gjeologo inxhinierike dhe hidrogeologjike te trojeve per objekte civile, per objekte te medha, porte e aeroporte, bazamente me ngarkesa te medha,i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet.
- Sherbime te natyres se projektimeve, mbikqyrje, kolaudim te impianteve te prodhimit dhe shperndarjes se energjise, studime te sizmiologjise inxhinierike, studime, projektime, mbikqyrje te ndertimit dhe mbylljes se venddepozitimeve te mbetjeve te ngurta.
- Studimi dhe pergatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri dhe ndertesave te cdo lloji.
- Hartimi i akteve te ekspertizes teknike per zjarret e rena.
- Sherbimet e Ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis (
- Auditim mjedor dhe vlerësim i ndikimit ne mjedis).
- Ndertim, projektim, zbatim, mbikqyrje, kolaudim,ristrukturim etj, te objekteve sociale, kulturore, ekonomike,industrial, objekte banimi.
- Ndertim godina banimi me fonde e veta,te shoqerise ashtu dhe me fonde publike dhe kredi bankare.
- Ndertime me karakter social kulturor dhe te kulteve te,ndryshme fetare si dhe restaurime
- Aktivitet ne fushen e ndertimit ku perfshihen : Ndertim objektesh te permasave te ndryshme si shtepi, vila, ndertesa shumekateshe ose komplekse pallatesh, punime mirembajtje, sherbim fasade.
- Ndertim rrugesh dhe urash si dhe ndertime portuale, detare dhe ajrore si dhe rikonstrucionin e tyre, asfaltim dhe veshje me asfaltim.
- Ndertim digash, galeri, tunele, damba.
- Ndertim vepra kullimi, uijitje, impiante vaditese, punime mbrojtje dhe sisteme hidraulike, punime dhe sistemime elektrike, ndertim ambiente dhe sistemim gjelberimi, parqe e lulishte, nyje betoni, import eksport te artikujve te ndryshem si dhe skrap (mbeturina hekurishtesh), transporti dhe pune, traktore, fadroma te te gjitha llojeve, transportues, makina asfaltimi, makineri e pajisje per nyje betoni.
- Ndertim pika karburanti dhe tregtim me pakice te nenproduktheve te naftes.
- Veprimitari private ne fushen e ndertimin e linjave elektrike te TN,TM,TU mbi tokesore (ajrore) dhe nentokesore (kabllore) per energji elektrike dhe telekomunikacioni, nenstacionet elektrike TN/TM dhe te tensionit te mesem TM/TU (kabina elektrike), centrale dhe hidrocentrale, rrjete inxhinierike, objekte civile dhe industriale.


Për të arritur objektin e kompanisë dhe pa e zgjeruar atë, shoqeria mund të kryejë të gjitha veprimet për pronën e luajtshme dhe të paluajtshme dhe çdo aktivitet tjeter të nevojshëm ose të dobishëm, ne funksion te objektit te shoqerise edhe pa e zgjeruar ate.

Neni 8

Kapitali themeltar i Shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë do te jete 100.000 leke,

Joana Dhiamandi zotëron një kuotë, ekuivalente me 100% të kapitalit themeltar, të barabartë me 100.000 lekë ne vlerë nominale.



Neni 9

Transferimi i kuotave të zotëruara në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit mund të transferohen lirisht ndërmjet personave juridikë ose fizikë me anë të një kontrate ndërmjet palëve.

Pjesët e kapitalit mund ti tranferohen palëve të treta, pasi të jenë refuzuar nga ortakët aktualë e drejta e parablerjes, në rast se janë më shumë se një ortak.

Pjesë e kapitalit janë në rrugë trashëgimie lirisht të transferueshme, pas vendimit të ortakëve për transferimin e pjesës së kapitalit tek trashgimtarët në rast se janë më shumë se një ortak.

Neni 10

Zvogëlimi ose rritja e kapitalit themeltar

Ortakët mund të rrisin ose zvogëlojnë kapitalin në masën e lejuar nga ligji, ose të ndryshojnë formën ligjore të shoqërisë vetem me vendim te asamblese.

Neni 11

Organet vendimmarrëse

Ortaku i vetëm i shoqërisë

Shoqëria themelohet nga një ortak i vetem, dhe ne keto kushte ortaku i vetëm është organi vendimmarrës, i cili drejton aktivitetin e shoqërisë nëpërmjet vendimit të ortakut të vetëm per sa vijon:

- a. miratimi i politikave të shoqërisë
- b. ndryshimi i statutit të shoqërisë
- c. emërimin ose shkarkimin e administratorëve dhe përcaktimin e kompetencave të tyre
- d. emërimin ose shkarkimin e audituesit
- f. përcakton shperblimet per personat e përmendur në paragafin c, d.
- e. ndryshimi i selisë
- f. ndryshimi i emrit të shoqërisë
- g. rritjen ose uljen e kapitalit të shoqërisë
- k. ndarjen ose anullimin e kuotave të shoqërisë
- h. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- i. miratimin e rregullave proceduriale për mbledhjen e asamblesë
- j. të tjera të përcaktuara nga dispozitat ligjore në fuqi ose statuti

Neni 12

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme do të thirret në formë të shkruar me postë rekondë, ose nëpërmjet çdo poste të certifikuar të dërguar nga administratori në rastin që kërkohet nga ai dhe në çdo rast tjeter.

Komunikimi duhet të përbajë vendin, kohën e takimit dhe orën e mbledhjes, për tu dërguar të gjithë ortakëve, nuk mblidhet në zbatim te sa në paragafin 1 të këtij nenit, ajo quhet e vlefshme kur të gjitha palët bien dakord edhe në rast parregullsie.

Neni 13

Vendimmarrja

Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të ortakëve që marrin pjesë në kapitalin themeltar, për ndryshimin e statutit, për të rritur ose ulur kapitalin themeltar, shpërndarjen e fitimeve, organizimin dhe shpërbërjen e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë për çështje të tilla si:

- a. Përcakton politikat e shoqërisë,
- b. Emëron dhe shkarkon administratorët si dhe përcakton kompetencat e tyre,
- c. Emëron dhe shkarkon auditorët,
- d. Përcakton kompèsimin ose shpërblimin për sa më sipër,
- e. Përfaqësimi në gjykatë dhe përfaqësimi të tjera administrative,
- f. Miraton rregulloren e brendshme për mbledhjen e asamblesë,

Çdo ndryshim duhet të dorëzohet në Registrin e Shoqërive Tregtare, në QKB për regjistrim.

Neni 14

Administrimi i Shoqërisë

Administrimi i shoqërisë i është besuar një administratori të vetëm.

Administratori menaxhon punën e përditshme të shoqërisë dhe është përgjegjës për aktivitetet e mëposhtme:

- Ekzekutimi i operacioneve të përditshme të shoqërisë,
- Përfaqësuesi i shoqërisë kundrejt palëve të treta, saktësisht ose me zëvendësim të caktuar me prokurë,
- Hartimi dhe mbajtja e pasqyrave financiare, propozimi i auditorëve, nëse është e nevojshme,
- Përgatitja e dokumentave në emër të shoqërisë,
- Përgatitja e kontratave të punësimit dhe zgjidhja e tyre sipas çdo çështje,
- Aktivitete të tjera të çdo lloji në dobi të shoqërisë dhe realizimit të objektit të saj.

Shoqëria do të administrohet nga administratori i saj Znj. Joana Dhiamandi, e bija e Vasilit, lindur më datë 07/03/1989, në Permet, banuese në Tirane, në rr. Emin Duraku nr.8, H.3, Ap. 3, 1019 identifikuar me ID I95307053P, me kapacitet të plotë juridik për të vepruar me kapacitet të plotë për të vepruar për 5 vjet me të drejtë rinnovimi.

Neni 15

Ushtrimi

Viti finanziar i shoqërisë nis nga 1 janari dhe përfundon më 31 dhjetor.

Përjashtimisht, viti i parë i shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon 31 dhjetor.

Neni 16

Të ardhurat, dividentët

Shoqëria do të krijojë një fond rezervë për realizimin e objektit.

Fitimi pas përfundimit të vitit finanziar dhe pas pagesës së tatimeve, mund të ndahet nga ortakët e shoqërisë.

Neni 17

Shpërndarja dhe likuidimi

Shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a. Fundi i kohëzgjatjes së aktivitetit të parashikuar
- b. Me vendimin e mbledhjes së ortakëve/ortakut themelues
- c. Hapja e procedurave të falimentimit.
- d. Nëse nuk kryen aktivitet tregtar për dy vite të vazhdueshme dhe nuk është shpallur pezullimi i regjistruar në QKB
- e. Me vendim gjyqi likuiduesi raporton mbi gjendjen e aseteve dhe detyrimeve të shoqërisë në operacionet e mëtejshme të shlyerjes dhe kohën e nevojshme për mbylljen e procesit. Në fund të këtij procesi, ortaku do të informohet për balancën dhe mbylljen e procedurës së likuidimit.

Neni 18

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind gjatë aktivitetit të shoqërisë, në qoftë se nuk zgjidhet miqësisht, palët janë të drejtuar Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit, përvèç kur kompetente për të zgjidhur mosmarrëveshjet në bazë të ligjit është gjykata shqipëtare.

E-mail i komunikimit me ortakun do të jetë:

- Joana.dhiamandi@gmail.com

Ky statut është shkruar në dy kopje origjinale ne 4 flete.

Ortaku themelues
Joana Dhiamandi

